

A ka efekte anësore?

Zakonisht, mund të ndodhë të kesh pak ënjtje, skuqje ose rritje të ndjeshmërisë të vendi ku është bërë injektimi. Mund të të dalë një gungë e vogël që nuk të dhemb, por që zakonisht zhduket brenda pak javësh. Efektet anësore të rënda janë të rralla, por në to bëjnë pjesë ethet (temperatura), dhimbja e kokës, marramendja ose pafuqia, të vjellat dhe ënjtja e gjëdrave.


Nëse nuk ndihesh mirë pasi të kesh bërë vaksinën, pi një paracetamol. Lexoji me kujdes udhëzimet në shishe ose në paketë dhe përdor dozën e duhur për moshën tënde. Nëse është nevoja, merr një dozë të dytë 4 deri në 6 orë më vonë.

Nëse, edhe pas dozës së dytë, vazhdon të kesh temperaturë, fol me mjekun e familjes ose telefono falas në numrin 111 të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar (NHS).

Nëse pëson ndonjë efekt anësor që dyshohet se ka të bëjë me vaksinimin, atë mund ta raportosh në uebsajtin "Yellow Card" (Karta e Verdhë), duke telefonuar në numrin 0800 731 6789 (nga ora 09:00 deri në orën 17:00, nga e hëna në të premte) ose nga aplikacioni "Yellow Card" për telefona. www.mhra.gov.uk/yellowcard

Tani është momenti i duhur për të verifikuar që i ke bërë të gjitha vaksinat

Vaksinimi për adoleshentët



Vaksinat nga NHS-ja



Për të mësuar më shumë në lidhje me vaksinimin për adoleshentët, vizito faqen: www.nhs.uk/vaccinations ose lexo materialin: <https://qrco.de/YoungPeopleImms>



Nuk është shumë vonë për të bërë dozat që duhej t'i kishe bërë.

Kjo fletëpalosje është hartuar nga Agjencia e Mbretërisë së Bashkuar për Sigurinë e Shëndetit (UK Health Security Agency).

© Crown copyright 2023. 1P 100K JULY 2023 (APS). Product code: YP3BG1AL Albanian. UK Health Security Agency gateway number: 2023161.

Këtë fletëpalosje mund ta porosisësh ose shkarkosh nga:

www.healthpublications.gov.uk, duke telefonuar në numrin: 0300 123 1002

(linja është e hapur nga ora 08:00 deri në orën 18:00, nga e hëna në të premten).

Mund të porosisësh kopje të shtypura të kësaj fletëpalosjeje në gjuhën angleze.

Mund të porosisësh edhe variante të përkthyer të kësaj fletëpalosjeje në gjuhë të tjera.



UK Health
Security
Agency

Vaksina përforcuese "Td/IPV" 3 në 1 për adoleshentë



Në moshën 14-vjeçare ose gjatë vitit të 9-të të shkollës, përmbush kriteret për të bërë një dozë përforcuese 3 në 1 të vaksinës për adoleshentë, e cila parandalon tetanosin, difterinë dhe poliomielitin. **Vaksina "Td/IPV" përforcon imunitetin e trupit ndaj këtyre sëmundjeve infektive, sepse imuniteti mund të jetë dobësuar gjatë rritjes.**

Nga çfarë më mbron kjo vaksinë?

T

Tetanos

Tetanos është sëmundje e dhimbshme që prek sistemin nervor, çka mund të çojë në tkurje të muskujve dhe në probleme me frymëmarrjen dhe mund të shkaktojë vdekje. Sëmundja shkaktohet kur mikrobet, që jetojnë në plehun organik dhe në dhe, hyjnë në trup nëpërmjet plagëve të hapura ose djegieve. Tetanos nuk transmetohet nga njëri person në tjetrin.

D

Difteria

Difteria është sëmundje e rëndë që fillon zakonisht me dhimbje fyti, por që shpejt mund të shkaktojë probleme me frymëmarrjen. Mund të dëmtojë zemrën dhe sistemin nervor dhe, në raste të rënda, mund të shkaktojë vdekje.

IPV

Poliomieliti

Poliomieliti është virus që prek sistemin nervor dhe mund të shkaktojë paralizë të përhershme të muskujve. Mund të shkaktojë vdekje nëse prek muskujt e krahavorit ose trurin.

Vaksina përforcuese për adoleshentë quhet "Revaxis". Për të mësuar më shumë në lidhje me të, lexo "Fletëpalosjen informuese për pacientët" në faqen: www.medicines.org.uk/emc/product/5581/pil

Po ta kem bërë vaksinën kundër tetanosit, difterisë dhe poliomielitit kur isha fëmijë, a jam ende plotësisht i/e mbrojtur?

Jo. Duhet të bësh një dozë përforcuese për të përmirësuar efektin e vaksinave që ke bërë më herët.

Sa doza përforcuese duhet të bëj?

Për të përmirësuar imunitetin, duhet të bësh gjithsej 5 doza të vaksinave të tetanosit, difterisë dhe poliomielitit.

Duhet të kesh bërë:



3 dozat e para

kur ke qenë foshnjë



dozën e 4-t

kur ke qenë në moshën 3 deri në 5-vjeçare. Kjo dozë përforcuese bëhet në periudhën përpara fillimit të shkollës



dozën e 5-të

në vitin e 9-të të shkollës (mosha 13-14 vjeçare)

A do të më duhet të bëj doza të tjera përforcuese në të ardhmen?

Ka të ngjarë që nuk do të të duhet të bësh më doza përforcuese të këtyre vaksinave. Megjithatë, mund të të duhet të bësh disa vaksina nëse shkon në shtete të caktuara ose, nëse pëson ndonjë lëndim ose plagosje, mund të të duhet të bësh një injektim kundër tetanosit. Pyet infermieren te mjeku i familjes.

Si do ta bëj vaksinën përforcuese "Td/IPV"?

Do të të bëjnë një injektim në krah. Eh, askujt nuk i pëlqejnë injektimet, por do të zgjasë fare pak! Gjilpërat janë shumë të holla, prandaj shpimin do ta ndiesh fare pak. Nëse injektimet të shqetësojnë, fol me infermieren ose doktorin përpara se ta bësh këtë injektim.

A ka vaksina të tjera që duhet të bëj tani për tani?

Duke bërë vaksinën përforcuese "Td/IPV", përmbush kriterin për të bërë edhe vaksinën "MenACWY". Këtë vaksinë duhet ta bësh përpara se të mbarosh shkollën. Fol me infermieren e shkollës nëse nuk e ke bërë ende vaksinën dhe je ende në shkollë. Nëse e ke mbaruar shkollën, kontakto me mjekun e familjes për të lënë një takim që të bësh vaksinën. Është mirë të pyesësh te mjeku i familjes nëse i ke bërë të gjitha vaksinat, duke përfshirë vaksinën për HPV-në dhe MMR-në (fruthi, shytat dhe rubeola).

Nëse nuk e ke bërë kurrë më përpara vaksinën MMR, duhet të bësh një dozë tani dhe një tjetër pas 1 muaji, për t'u mbrojtur nga fruthi, shytat dhe rubeola.

